

UNIK CONSTRUCTION sh.p.k.

RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË TË AUDITUESIT LIGJOR

Mbi ndryshimet në pasqyrën financiare të kapitaleve të veta më 04 Prill 2025

Përmbajtja

1. Raporti i Dhënies Sigurisë i Audituesit Ligjor.
2. Shënime mbi pasqyrën financiare të kapitaleve të veta datë 04 Prill 2025, për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

## RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR

Drejtuar :

### ASAMBLESE SË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k.

#### Qëllimi i angazhimit:

Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k. me vendim të datës 24 Mars 2025 më ka angazhuar si Auditues Ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë sigurinë e arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave në Pasqyrën Financiare të Kapitaleve të veta, për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë duke përdorur si burim financimin kontributin në natyrë të pasurisë së paluajtshme të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, zona kadastrale 2119, Yzberisht , Katund i Ri, Tiranë : **Are me sipërfaqe 12012 m2, me numër pasurie 209/36, regjistruar në volumn 1, faqe 246** me vlerë totale 300,000 euro ose e konvertuar në monedhën lekë 29,740,000 lekë.

#### Kriteret:

Si bazë për angazhimin e verifikimit të mundësisë për zmadhimin e kapitalit, ne jemi referuar:

1. Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 'Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare'.
2. Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.
3. Ligjit nr. 25/2018 datë 10.05.2018 'Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare'.
4. Ligjit 10091 datë 05.03.2009 'Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar'.
5. Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 'Për Regjistrimin e Biznesit'.
6. Vendimi datë 24 Mars 2025 të Asamblesë së Ortakut të vetëm të shoqërisë për zmadhimin e kapitalit.

#### Përgjegjësia e Drejtimit:

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë në Pasqyrën Financiare të Kapitaleve të veta për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në datën 04 Prill 2025 në përputhje me kriteret e sipërpërmendura . Kjo përgjegjësi përfshin : hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave të gjendjes së kapitalit dhe ndryshimin e tij si rezultat i zmadhimit, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale , qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve, zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabel dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare .

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të ortakëve të shoqërisë dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të kuotave që i takon ortakut të shoqërisë në momentin e zmadhimit të kapitalit. Drejtimi është përgjegjës për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e asamblesë me rend dite zmadhimin e kapitalit .

## **Përgjegjësia jonë:**

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera të shprehim një opinion mbi pasqyrën e gjendjes së kapitalit dhe ndryshimin e tij si rezultat i zmadhimit. **Ne e kryem auditimin në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) ' Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike' dhe standartet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshëm që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale.**

### **A. Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë :**

1. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në pasqyrën e Kapitaleve të Veta me ato të Pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2024.
2. Verifikimin e kontributit në natyrë deri më 24 Mars 2025.
3. Verifikimin e llogaritjeve për numrin e kuotave dhe vlerën e ndryshuar si efekt të zmadhimit kapitalit të shoqërisë.
4. Të tjera çështje që vlerësohen të rëndësishme për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

### **B. Konkluzioni bazuar në procedurat e kryera:**

1. Vlera e kapitalit deri më datën 24 Mars 2025 është 10,000,000 leke. Kjo shumë rakordon me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam.
2. Bazuar në vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë shuma që do të përdoret për të realizuar zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në natyrë është 29,740,000 Lekë.

Kontributi në natyrë me pasurinë e paluajtshme të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , zona kadastrale 2119, Yzberisht , Katund i Ri, Tiranë: **Are me sipërfaqe 12012 m2, me numër pasurie 209/36, regjistruar në volumin 1, faqe 246** me vlerë totale 300,000 euro ose e konvertuar në monedhën lekë 29,740,000 lekë. Bashkepronasi ½ sipas certifikates se regjistrimit te pronesise leshuar me date 18.07.2024 ne pronesi te Skifter Besnik Picari dhe Anida Demir Picari.

- ✓ Kontributi në natyrë i z. Skifter Besnik Picari , me numër identifikimi I10328119N ,me pasurinë e paluajtshme të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , zona kadastrale 2119, Yzberisht , Katund i Ri, Tiranë: Are me sipërfaqe 12012 m2, me numër pasurie 209/36, regjistruar në volumin 1, faqe 246 me vlerë 150,000 euro ose e konvertuar në monedhën lekë 14,870,000 lekë. Bashkepronasi ½ sipas certifikates se regjistrimit te pronesise leshuar me date 18.07.2024.
- ✓ Kontributi në natyrë i znj. Anida Demir Picari , me numër identifikimi I26203072Q ,me pasurinë e paluajtshme të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , zona kadastrale 2119, Yzberisht , Katund i Ri, Tiranë: Are me sipërfaqe 12012 m2, me numër pasurie 209/36, regjistruar në volumin 1, faqe 246 me vlerë 150,000 euro ose e konvertuar në monedhën lekë 14,870,000 lekë. Bashkepronasi ½ sipas certifikates se regjistrimit te pronesise leshuar me date 18.07.2024.

3. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalet e veta është si më poshtë:

(Shumat në Lek)

	Gjendja me 31 Dhjetor 2024	Rritja e Kapitalit ne natyre 04.04.2025	Gjendja me 4 Prill 2025
Kapitali	10,000,000	29,740,000	39,740,000
	10,000,000	29,740,000	39,740,000

4. Struktura e pronësisë është si më poshtë.

Ortakët e Shoqërisë	Vlera e kuotes (Lek) me 31 Dhjetor 2024	Pjesmarrja ne %	Vlera e kuotes (Lek) me 4 Prill 2025	Pjesmarrja ne %
Skifter Picari	10,000,000	100%	24,870,000	62.58%
Anida Picari	-	-	14,870,000	37.42%
	10,000,000	100%	39,740,000	100%

**Opinion:**

Informacioni financiar i paraqitur nga 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k në lidhje me zmadhimin e kapitalit është përgatitur në mënyrë të drejtë dhe të përputhshme me kërkesat ligjore dhe statutore përkatëse.

Kufizimet në përdorim :

Pasqyra Financiare e Kapitaleve të veta , për qëllim të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në datën 04 Prill 2025, është përgatitur të ndihmojë 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k., për të regjistruar zmadhimin e kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Raporti ynë është përgatitur vetëm për 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k. dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nuk duhet të shpërndalet në ndonjë palë të tretë të ndryshme nga 'UNIK CONSTRUCTION' Sh.p.k. dhe Qendrës Kombëtare te Biznesit pa maritimim paraprak te Audituesit Ligjor.

Tiranë, më 04.04.2025

Edi Kokiçi

Auditues Ligjor



Adresa : Rruga Dhimitër Shuteriqi , pranë qendrës Kristal, Tiranë